

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCES	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5–16

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	113,803	421,118
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	400,000	2,030,501
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,605	2,605
Shpenzime të shtyra	7	1,487,081	-
Total Aktive Afatshkurtra		2,003,489	2,454,224
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	561,323	722,754
Total aktive afatgjata		561,323	722,754
Total aktive		2,564,812	3,176,978
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	9	2,356,097	1,222,317
Detyrime tatimore	10	18,625	101,429
Të ardhurat e shtyra	11	-	987,778
Të tjera detyrime	12	190,090	865,454
Total detyrime afatshkurtra		2,564,812	3,176,978
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		2,564,812	3,176,978
Kapitali			
Total kapitali aksionar		-	-
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,564,812	3,176,978

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performances

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	13	14,005,382	46,674,441
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	14	28,898	(1,336,927)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(13,043,645)	(44,070,674)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	15	(11,230,129)	(37,456,107)
2) Të tjera shpenzime	16	(1,813,516)	(6,614,567)
Shpenzime të personelit	17	(825,149)	(1,111,602)
1) Paga dhe shpërblime		(695,769)	(943,809)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(129,380)	(167,793)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(161,431)	(151,601)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	18	(4,519)	(3,637)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare		464	-
2) Shpenzime të tjera financiare	19	464	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		-	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31.12.2024 u firmosën si më poshtë:

Besnik Velu
Besnik Velu



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	-	-
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	13,057	1,336,927
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	161,431	151,601
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	143,420	(1,455,001)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(612,166)	(1,166,355)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	47,500
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(294,258)	(1,085,328)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	(345,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	(345,000)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(294,258)	(1,430,328)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	421,118	3,188,373
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(13,057)	(1,336,927)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	113,803	421,118

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "F.SH.S.U." është regjistruar më 21 dhjetor 2017 pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është zhvillimi i aktiviteteve sportive universitare.

Presidenti i Federatës është Z. Besnik Veliu.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L81323451B. Selia qendrore e saj është në Rruga Liman Kaba, Parku Olimpik, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2024 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK për OJF) dhe ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Euro/LEK	98.15	103.88
USD/ LEK	94.26	93.94

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2024 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Lineare	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Lineare	20%
Mjete Transporti	Lineare	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Lineare	20%
Pajisje informatike	Lineare	25%
Të tjera	Lineare	20%

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 0%.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në bankë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në bankë	113,803	421,118
	113,803	421,118

5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare afatshkurtra

Llogaritë e arkëtueshme tregtare afatshkurtra më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Klientë vendas	400,000	2,030,501
	400,000	2,030,501

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogaritë të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tatim Fitimi	1,605	1,605
Të arkëtueshme nga Besjan Prekolaj	1,000	1,000
	2,605	2,605

7. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime te periudhave te ardhme per materiale konsumi kampionati	100,000	-
Shpenzime te periudhave te ardhme per kancelari	24,500	-
Shpenzime te periudhave te ardhme per promovim aktiviteti	255,000	-
Shpenzime te periudhave te ardhme per uniforma sportive	867,581	-
Shpenzime te periudhave te ardhme per blerje topash	240,000	-
	1,487,081	-

8. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	642,249	110,000	40,000	752,249
Shtesa	-	334,000	11,000	345,000
Gjendja më 31 dhjetor 2023	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Shtesa	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	(207,740)	(49,987)	(5,167)	(262,894)
Amortizimi i vitit	(86,752)	(57,149)	(7,700)	(151,601)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	(294,492)	(107,136)	(12,867)	(414,495)
Amortizimi i vitit	(69,402)	(84,403)	(7,627)	(161,431)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	(363,893)	(191,539)	(20,494)	(575,926)
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	434,509	60,013	34,833	529,355
Gjendja më 31 dhjetor 2023	347,757	336,864	38,133	722,754
Gjendja më 31 dhjetor 2024	278,356	252,461	30,506	561,323

9. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	2,356,097	1,222,317
	2,356,097	1,222,317

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	15,809	18,620
Tatim mbi te ardhurat personale	2,816	-
Tatim në Burim	-	82,809
	18,625	101,429

11. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Te ardhura te periudhave te ardheshme antaresime	-	687,778
Te ardhura te periudhave te ardhshme Shoqata	-	300,000
Kongresi Rinor Kombetar	-	-
	-	987,778

12. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pagat e punonjësve	48,090	48,090
Pagesa per individe me kontrate sherbimi	110,000	630,250
Financime Besnik Velu	32,000	17,000
Financim nga European Education Initiative	-	170,114
	190,090	865,454

13. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Te ardhura nga antaresimi	3,701,908	1,976,337
Te ardhura nga projekte brenda vendit	4,840,000	10,695,347
Te ardhura nga taksa pjesmarrje ne akt nderk	1,079,102	29,515,345
Te ardhura nga sponsorizimi	1,014,318	430,458
Te ardhura nga projekte jashte vendit	170,114	1,056,954
Te ardhura nga granti M. Sportit	3,199,940	3,000,000
	14,005,382	46,674,441

14. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(13,057)	(1,336,927)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	41,955	-
	28,898	(1,336,927)

15. Shpenzime per aktivitetet kryesore

Shpenzime per aktivitetet kryesore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Sherbime arbitrimi	952,500	2,195,594
Sherbime transporti	997,400	4,507,577
Sherbim qera mbjentesh sportive	494,000	1,228,500
Sherbim akomodimi per kampionate	1,352,850	11,906,468
Sherbim restoranti per kampionate	1,524,000	3,969,722
Sherbime mjekesore	-	500,592
Materiale konsumi per kampionatin	506,661	1,773,886
Shpenzime dietash	-	195,118
Shpenzime per uniforma sportive	2,301,919	3,564,800
Shpenzime per pjesmarrje ne aktivitete nderkombetare	2,436,281	1,309,296
Sherbime koordinimi dhe menaxhimi	289,118	3,869,793
Sherbim katering	-	452,500
Materiale konsumi per kampionatin te panjohura	-	18,300
Materiale mjekesore per kampionatin	-	90,729
Sherbime performimi dhe kercimi	-	315,232
Sherbime skenografie	-	632,000
Shpenzime per blerje topa te ndryshem	180,000	926,000
Shpenzime per blerje materiale sportive	195,400	-
	11,230,129	37,456,107

16. Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Karburant	108,899	216,097
Shpenzime per promovimin e aktivitetit	274,100	852,001
Sherbime audio	60,000	220,000
Sherbime Web	40,000	41,732
Sherbim interneti	17,920	55,590
Shpenzime bankare	75,842	91,437
Taksa dhe tarifa vendore	15,000	30,000
Shpernzime per pritje dhe perfaqesime	253,970	1,779,884
Sherbime financiare	194,100	477,275
Sherbime ligjore	85,900	79,400
Sherbime administrative	21,490	8,416
Shpenzime per honorare	-	110,000
Kuota antaresimi ne KOKSH	25,000	-
Shpenzime udhetimesh	504,366	718,694
Kancelari	13,400	38,953
Sherbime fotografike	123,529	306,472
Dieta per jashte vendit	-	24,335
Shpenzime per blerje inventar i imet	-	4,500
Sherbime marketingu	-	1,559,781
	1,813,516	6,614,567

17. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzime për paga	695,769	943,809
Shpenzime për sigurime shoq e shëndetësore	129,380	167,793
	825,149	1,111,602

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2024 ishte 1 punonjës.

18. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Gjopa dhe dëmshpërblime	4,519	3,637
	4,519	3,637

19. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitim nga kembimet valutore financiare	464	-
	464	-

20. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.